



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 843/8 prot.

Datë 12.05.2026

V E N D I M

Nr. 633/2026

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Fiorent Zguro	Nënkryetar
Kreshnik Ternova	Anëtar
Anila Malaj	Anëtar
Gjergj Mersini	Anëtar

Në mbledhjen e datës 12.05.2026, shqyrtoi çështjen me:

- Objekt:** Përfundimi i procesit së vlerësimit të ofertave dhe vazhdimi i mëtejshëm i procedurës së prokurimit “*E hapur mbi kufirin e lartë monetar*”, me nr. REF-70374-11-26-2025, me objekt: “*Loti 3 – Blerje vajra, lubrifikantë dhe alkool frenash*”, me fond limit 18,678,720.00 lekë pa TVSH, zhvilluar me datë 08-01-2026 nga autoriteti kontraktor, Drejtoria e Pergjithshme e Pastrimit dhe Gjelberimit Tirane.
- Ankimues:** Operatori ekonomik “Vëllezërit Agalliu 20” SHA me NUIS M07214203A dhe adresë: Skrofotine, Rruga Nacionale Vlore-Fier, Godina e Vellezerve Agalliu, Godina Nr.1, Vlorë.
- Autoriteti Kontraktor:** Drejtoria e Pergjithshme e Pastrimit dhe Gjelberimit me adresë Rruga “5 Maji”, Tirane
- Baza Ligjore:** Ligji nr. 162/2020 “*Për Prokurimin Publik*”, i ndryshuar; Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*”, i ndryshuar; Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “*Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik*”; Neni 4 i Vendimit të Komisionit të Prokurimit

Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim e pretendimet e ankimuesit, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi

## **Vëren:**

### **I**

#### *Vlerësimi Paraprak*

I.1. Vlera limit e përlogaritur për procedurën e prokurimit objekt-ankimi është mbi kufirin e ulët monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga të gjithë anëtarët, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” dhe Rregullat e Prokurimit Publik.

I.2. Operatori ekonomik ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.3. Operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”.

I.4. Ankimuesi nuk plotëson kushtet formale të paraqitjes së ankesës pranë Komisionit të Prokurimit Publik.

I.5. Ankimuesi nuk ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

### **II**

#### *Rrethanat e çështjes*

II.1. Në datën 27.11.2025, është publikuar në Sistemin e Prokurimeve Elektronike, procedura e prokurimit “E hapur mbi kufirin e lartë monetar”, me nr.REF-70374-11-26-2025, me objekt: “Lot 3: Blerje vajra, lubrifikantë dhe alkool frenash”, me fond limit 18,678,720 lekë pa tvsh, zhvilluar me datë 08.01.2026 nga autoriteti kontraktor, Drejtoria e Përgjithshme e Pastrimit dhe Gjelberimit.

II.2. Në datën 13.03.2026 nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është administruar ankesa me numër ankimi elektronik A/2026/6422 dhe nr. 843/2026 protokollit, datë 17.03.2026 e operatorit ekonomik “Vëllezërit Agalliu 20” SHA për procedurën e mësipërme të prokurimit.

Nga shqyrtimi paraprak i ankesës të sipërcituar, u konstatua se objekti i ankesës lidhet me veprimet proceduriale të ndjekura nga ana e autoritetit kontraktor sa i përket kësaj procedure.

II.3. Në përputhje me nenin 112 “Veprimet paraprake” të Ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, me marrjen e ankesës, Komisioni i Prokurimit Publik e publikoi atë në bazën e të dhënave të tij, e cila përmban të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe është publikuar formulari i publikimit Nr. Prot., 843/2 date 17.03.2026 lidhur me pretendimet e ankimuesit. Konkretisht objekti i pretendimeve në ankesën është si më poshtë vijon:

*“[...]Procedura në fjalë është mbyllur për dorëzim ofertash në datën 09.01.2026. Megjithatë, deri më sot nuk është publikuar në sistemin elektronik të prokurimeve publike asnjë njoftim mbi përfundimin e procesit të vlerësimit apo mbi statusin aktual të procedurës. Shoqëria jonë ka dërguar disa kërkesa për informacion pranë Autoritetit Kontraktor me qëllim marrjen e një sqarimi mbi ecurinë e procesit, por nuk kemi marrë asnjë përgjigje zyrtare. Sipas nenit 82 të VKM Nr. 285/2021 Për miratimin e rregullave të prokurimit publik , afati për shqyrtimin dhe vlerësimin e ofertave nuk duhet të kalojë 20 ditë për procedurat mbi kufirin e lartë monetar dhe 15 ditë për procedurat nën kufirin e lartë monetar, përveç rasteve kur afati pezullohet për arsye verifikimi. Në mungesë të çdo informacioni zyrtar apo publikimi në sistem, krijohet një situatë mungese transparence dhe tejkalimi të pajustificuar të afateve procedurale, duke cenuar parimet e barazisë, transparencës dhe konkurrencës së ndershme në procedurat e prokurimit publik. .”*

II.4. Nëpërmjet shkresës nr. 843/2 prot., datë 22.04.2026 me objekt: “Mbi detyrimin e autoritetit kontraktor për dhënie informacioni KPP-së lidhur me ankesën e operatorit ekonomik “Vëllezërit Agalliu 20” SHA dhe pagesën e tarifës së ankimit”, Komisioni i Prokurimit Publik i kërkoi autoritetit kontraktor informacion si vijon: “Në datën 13.03.2026 nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është administruar ankesa me numër ankimi elektronik A/2026/6422 dhe nr. 843/2026 protokoll, datë 17.03.2026 e operatorit ekonomik “Vëllezërit Agalliu 20” SHA për procedurën e prokurimit “E hapur mbi kufirin e lartë monetar”, me nr. REF-70374-11-26-2025, me objekt: “Loti 3 – Blerje vajra, lubrifikantë dhe alkool frenash”, me fond limit 18,678,720.00 lekë pa TVSH, zhvilluar me datë 08-01-2026 nga autoriteti kontraktor, Drejtoria e Përgjithshme e Pastrimit dhe Gjelberimit Tirane. Nga shqyrtimi paraprak i ankesës të sipërcituar, u konstatua se objekti i ankesës lidhet me veprimet proceduriale të ndjekura nga ana e autoritetit kontraktor sa i përket procedurës së mësipërme të prokurimit. Bazuar në nenin 112, pika 4, gërma “c” të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, ku parashikohet se: “Në mënyrë që ankesa të bëhet e aksesueshme jo vetëm nga autoriteti ose enti kontraktor, por njëkohësisht edhe nga operatorët ekonomikë të interesuar, KPP-ja publikon: a) ankesën e plotë në rastin e ankesave për dokumentet e tenderit; b) arsyet e skualifikimit në rastin e ankesave për vendimin e vlerësimit/klasifikimit përfundimtar; c) pretendimet mbi kualifikimin/skualifikimin e ofertuesve të tjerë duke referuar vetëm kriteret për të cilat ngrihen pretendime.”, në datën 17.03.2026, Komisioni i Prokurimit Publik publikoi objektin e pretendimeve që operatorit

ekonomik “Vëllezërit Agalliu 20” SHA, parashtron në ankesën e tij. Referuar nenit 114 “Trajtimi i ankesës nga autoriteti kontraktor ose enti kontraktor” të ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, parashikohet shprehimisht se: **“Në rastet e ankesave për vendimin e përzgjedhjes së kandidatëve pas fazës së parakualifikimit ose për procesin e vlerësimit të ofertave, autoriteti ose enti kontraktor duhet të shprehet për ankesën e paraqitur brenda 5 ditëve nga përfundimi i afatit kohor në dispozicion të operatorëve ekonomikë të interesuar, sipas parashikimeve në nenin 113 të këtij ligji, për paraqitjen e argumenteve të tyre.** 3. Në përfundim të shqyrtimit të ankesës sipas parashikimeve në këtë nen, autoriteti ose enti kontraktor mund të vendosë: a) pranimin e plotë të ankesës; b) pranimin e pjesshëm të ankesës; c) refuzimin e ankesës. 4. Në çdo rast, autoriteti ose enti kontraktor vë në dijeni për vendimin e marrë Komisionin e Prokurimit Publik, ankuesin, operatorët ekonomikë të interesuar brenda ditës së nesërme të punës nga marrja e këtij vendimi, duke e shoqëruar me shpjegimet dhe dokumentacionin përkatës. Aktualisht, nga ana e autoritetit kontraktor nuk është dërguar asnjë informacion lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik “Vëllezërit Agalliu 20” SHA, duke mos përmbushur detyrimin ligjor të parashikuar në nenin e sipërcituar, për vënien në dijeni për vendimin e marrë Komisionin e Prokurimit Publik, brenda ditës së nesërme të punës nga marrja e këtij vendimi, të shoqëruar me shpjegimet dhe dokumentacionin përkatës. Për sa më sipër, me qëllim vijimin e gjyqimit të ankesës pranë KPP-së, në përputhje me nenin 114 të LPP-së, autoriteti kontraktor të dërgojë pranë Komisionit të Prokurimit Publik, brenda ditës së nesërme të punës nga marrja e kësaj shkrese, informacion të hollësishëm mbi procedurën e mësipërme të prokurimit, ku të pasqyrohet procesi i shqyrtimit dhe vlerësimit të ofertave; të jepen argumentimet përkatëse mbi pretendimet e operatorit ekonomik “Vëllezërit Agalliu 20” SHA, vendimin e autoritetit tuaj lidhur me trajtimin e ankesës së operatorit ekonomik “Vëllezërit Agalliu 20” SHA si dhe veprimet procedurale të kryera nga ana juaj sipas parashikimeve të nenit 111/3 të ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” dhe nenit 94/4 të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, për plotësimin e të metave të ankesave, lidhur me pagesën e tarifës së ankimit.” Kjo shkresë i është dërguar për dijeni edhe operatorit ekonomik ankues “Vëllezërit Agalliu 20” SHA.

II.5. Në datën 30.04.2026 është protokolluar në Komisionin e Prokurimit Publik me nr.843/3 prot., shkresa e autoritetit kontraktor nr.121/40 prot., datë 28.04.2026 me objekt: **“Kthim përgjigje mbi trajtimin e ankesës së OE “Vëllezërit Agalliu” SHA dhe pagesën e tarifës së ankimit përprocedurën e prokurimit me nr. REF-70374-11-26-2025 (Loti 3)”**. Referuar kësaj shkresëe rezulton se autoriteti kontraktor ka refuzuar pretendimet e operatorit ekonomik ankues, pasi [...] **ankesa është paraqitur përpara publikimit të rezultatit të vlerësimit/klasifikimit dhe përpara publikimit të njoftimit të fituesit apo të anulimit si dhe pa përmbushur elementët formale të detyrueshme, konkretisht pa paraqitur mandatpagesën përkatëse. Për rrjedhojë ajo mbetet juridikisht e parakohshme, e paplotë dhe nuk mund të merret në shqyrtim.**

II.6. Nëpërmjet shkresës nr. 843/4 prot., datë 04.05.2026 me objekt: **“Kërkesë për verifikim pagese”**, Komisioni i Prokurimit Publik i kërkoi Sektorit të Financës, Burimeve Njerëzore dhe Trajnimeve pranë këtij Komisioni, nëse operatori ekonomik “Vëllezërit Agalliu 20” SHA

ka korigjuar apo jo pranë KPP-së dokumentin bankar që vërteton pagesën e tarifës për ankesën e paraqitur për procedurën e prokurimit të sipërcituar.

II.7. Në datën 07.05.2026, nëpërmjet shkresës nr. 843/5 prot., Sektori i Financës, Burimeve Njerëzore dhe Trajnimeve pranë KPP-së informon se: *“Në përgjigje të kërkesës suaj nr. 843/4 prot., datë 04.05.2026 me objekt: “Kërkesë për verifikim pagese”, ju bëjmë me dije se për ankesën nr. 843/2026 prot, datë 17.03.2026, me numër ankimi elektronik me nr. A/2026/6422, operatori ekonomik “Vëllezërit Agalliu 20” SHA nuk ka paraqitur dokumentin bankar që vërteton pagesën. Refereruar kërkesës suaj tuaj, janë kryer verifikime me raportin e Degës së Thesarit, për arkëtime të periudhës Mars- Prill dhe rezulton se operatori ekonomik “Vëllezërit Agalliu 20” SHA nuk ka kryer pagesë në favor të Komisionit të Prokurimit Publik për ankesën e sipërcituar.”*

II.8. Nga verifikimi i dokumentacionit të administruar në dosjen e shqyrtimit administrativ, si dhe bazuar në informacionin e Autoritetit Kontraktor, u konstatua, se nuk ka pasur pretendime nga subjekte të interesuara, në përputhje me nenin 113 ligji Nr. 162/2020, për prokurimin publik.

## II

### **Komisioni i Prokurimit Publik**

Komisioni i Prokurimit Publik, pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur saj si dhe informacionit të paraqitur nga autoriteti kontraktor

#### **Arsyeton:**

III.1. Në datën 27.11.2025, është publikuar në Sistemin e Prokurimeve Elektronike, procedura e prokurimit *“E hapur mbi kufirin e lartë monetar”*, me nr.REF-70374-11-26-2025, me objekt: *“Lot 3: Blerje vajra, lubrifikantë dhe alkool frenash”*, me fond limit 18,678,720 lekë pa tvsh, zhvilluar me datë 08.01.2026 nga autoriteti kontraktor, Drejtoria e Përgjithshme e Pastrimit dhe Gjelberimit.

III.2. Në datën 13.03.2026 nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është administruar ankesa me numër ankimi elektronik A/2026/6422 dhe nr. 843/2026 protokoli, datë 17.03.2026 e operatorit ekonomik *“Vëllezërit Agalliu 20”* SHA për procedurën e mësipërme të prokurimit.

Nga shqyrtimi paraprak i ankesës të sipërcituar, u konstatua se objekti i ankesës lidhet me veprimet proceduriale të ndjekura nga ana e autoritetit kontraktor sa i përket kësaj procedure.

III.3. Në përputhje me nenin 112 *“Veprimet paraprake”* të Ligjit nr.162/2020 *“Për Prokurimin Publik”*, me marrjen e ankesës, Komisioni i Prokurimit Publik e publikoi atë në bazën e të dhënave të tij, e cila përmban të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të

procedurës), si dhe është publikuar formulari i publikimit Nr. Prot., 843/2 date 17.03.2026 lidhur me pretendimet e ankimuesit. Konkretisht objekti i pretendimeve në ankesën është si më poshtë vijon:

*“[...]Procedura në fjalë është mbyllur për dorëzim ofertash në datën 09.01.2026. Megjithatë, deri më sot nuk është publikuar në sistemin elektronik të prokurimeve publike asnjë njoftim mbi përfundimin e procesit të vlerësimit apo mbi statusin aktual të procedurës. Shoqëria jonë ka dërguar disa kërkesa për informacion pranë Autoritetit Kontraktor me qëllim marrjen e një sqarimi mbi ecurinë e procesit, por nuk kemi marrë asnjë përgjigje zyrtare. Sipas nenit 82 të VKM Nr. 285/2021 Për miratimin e rregullave të prokurimit publik , afati për shqyrtimin dhe vlerësimin e ofertave nuk duhet të kalojë 20 ditë për procedurat mbi kufirin e lartë monetar dhe 15 ditë për procedurat nën kufirin e lartë monetar, përveç rasteve kur afati pezullohet për arsye verifikimi. Në mungesë të çdo informacioni zyrtar apo publikimi në sistem, krijohet një situatë mungese transparence dhe tejkalimi të pajustificuar të afateve procedurale, duke cenuar parimet e barazisë, transparencës dhe konkurrencës së ndershme në procedurat e prokurimit publik. .”*

III.4. Nëpërmjet shkresës nr. 843/2 prot., datë 22.04.2026 me objekt: *“Mbi detyrimin e autoritetit kontraktor për dhënie informacioni KPP-së lidhur me ankesën e operatorit ekonomik “Vëllezërit Agalliu 20” SHA dhe pagesën e tarifës së ankimit”, Komisioni i Prokurimit Publik i kërkoi autoritetit kontraktor informacion si vijon: “Në datën 13.03.2026 nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është administruar ankesa me numër ankimi elektronik A/2026/6422 dhe nr. 843/2026 protokoll, datë 17.03.2026 e operatorit ekonomik “Vëllezërit Agalliu 20” SHA për procedurën e prokurimit “E hapur mbi kufirin e lartë monetar”, me nr. REF-70374-11-26-2025, me objekt: “Loti 3 – Blerje vajra, lubrifikantë dhe alkool frenash”, me fond limit 18,678,720.00 lekë pa TVSH, zhvilluar me datë 08-01-2026 nga autoriteti kontraktor, Drejtoria e Pergjithshme e Pastrimit dhe Gjelberimit Tirane. Nga shqyrtimi paraprak i ankesës të sipërcituar, u konstatua se objekti i ankesës lidhet me veprimet proceduriale të ndjekura nga ana e autoritetit kontraktor sa i përket procedurës së mësipërme të prokurimit. Bazuar në nenin 112, pika 4, gërma “c” të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, ku parashikohet se: “Në mënyrë që ankesa të bëhet e aksesueshme jo vetëm nga autoriteti ose enti kontraktor, por njëkohësisht edhe nga operatorët ekonomikë të interesuar, KPP-ja publikon: a) ankesën e plotë në rastin e ankesave për dokumentet e tenderit; b) arsyet e skualifikimit në rastin e ankesave për vendimin e vlerësimit/klasifikimit përfundimtar; c) pretendimet mbi kualifikimin/skualifikimin e ofertuesve të tjerë duke referuar vetëm kriteret për të cilat ngrihen pretendime.”, në datën 17.03.2026, Komisioni i Prokurimit Publik publikoi objektin e pretendimeve që operatorit ekonomik “Vëllezërit Agalliu 20” SHA, parashtron në ankesën e tij. Referuar nenit 114 “Trajtimi i ankesës nga autoriteti kontraktor ose enti kontraktor” të ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, parashikohet shprehimisht se: **“Në rastet e ankesave për vendimin e përzgjedhjes së kandidatëve pas fazës së parakualifikimit ose për procesin e vlerësimit të ofertave, autoriteti ose enti kontraktor duhet të shprehet për ankesën e paraqitur brenda 5 ditëve nga përfundimi i afatit kohor në dispozicion të operatorëve ekonomikë të interesuar, sipas parashikimeve në nenin 113 të këtij ligji, për paraqitjen e argumenteve të tyre. 3. Në***

*përfundim të shqyrtimit të ankesës sipas parashikimeve në këtë nen, autoriteti ose enti kontraktor mund të vendosë: a) pranimin e plotë të ankesës; b) pranimin e pjesshëm të ankesës; c) refuzimin e ankesës. 4. Në çdo rast, autoriteti ose enti kontraktor vë në dijeni për vendimin e marrë Komisionin e Prokurimit Publik, ankuesin, operatorët ekonomikë të interesuar brenda ditës së nesërme të punës nga marrja e këtij vendimi, duke e shoqëruar me shpjegimet dhe dokumentacionin përkatës. Aktualisht, nga ana e autoritetit kontraktor nuk është dërguar asnjë informacion lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik “Vëllezërit Agalliu 20” SHA, duke mos përmbushur detyrimin ligjor të parashikuar në nenin e sipërcituar, për vënien në dijeni për vendimin e marrë Komisionin e Prokurimit Publik, brenda ditës së nesërme të punës nga marrja e këtij vendimi, të shoqëruar me shpjegimet dhe dokumentacionin përkatës. Për sa më sipër, me qëllim vijimin e gjykimit të ankesës pranë KPP-së, në përputhje me nenin 114 të LPP-së, autoriteti kontraktor të dërgojë pranë Komisionit të Prokurimit Publik, brenda ditës së nesërme të punës nga marrja e kësaj shkrese, informacion të hollësishëm mbi procedurën e mësipërme të prokurimit, ku të pasqyrohet procesi i shqyrtimit dhe vlerësimit të ofertave; të jepen argumentimet përkatëse mbi pretendimet e operatorit ekonomik “Vëllezërit Agalliu 20” SHA, vendimin e autoritetit tuaj lidhur me trajtimin e ankesës së operatorit ekonomik “Vëllezërit Agalliu 20” SHA si dhe veprimet proceduriale të kryera nga ana juaj sipas parashikimeve të nenit 111/3 të ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” dhe nenit 94/4 të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, për plotësimin e të metave të ankesave, lidhur me pagesën e tarifës së ankimit.” Kjo shkresë i është dërguar për dijeni edhe operatorit ekonomik ankimes “Vëllezërit Agalliu 20” SHA.*

III.5. Në datën 30.04.2026 është protokolluar në Komisionin e Prokurimit Publik me nr.843/3 prot., shkresa e autoritetit kontraktor nr.121/40 prot., datë 28.04.2026 me objekt: “*Kthim përgjigje mbi trajtimin e ankesës së OE “Vëllezërit Agalliu” SHA dhe pagesën e tarifës së ankimit përprocedurën e prokurimit me nr. REF-70374-11-26-2025 (Loti 3)*”. Referuar kësaj shkresëe rezulton se autoriteti kontraktor ka refuzuar pretendimet e operatorit ekonomik ankimes, pasi [...] *ankesa është paraqitur përpara publikimit të rezultatit të vlerësimit/klasifikimit dhe përpara publikimit të njoftimit të fituesit apo të anulimit si dhe pa përmbushur elementët formale të detyrueshme, konkretisht pa paraqitur mandatpagesën përkatëse. Për rrjedhojë ajo mbetet juridikisht e parakohshme, e paplotë dhe nuk mund të merret në shqyrtim.*

III.6. Nëpërmjet shkresës nr. 843/4 prot., datë 04.05.2026 me objekt: “*Kërkesë për verifikim pagese*”, Komisioni i Prokurimit Publik i kërkoi Sektorit të Financës, Burimeve Njerëzore dhe Trajnimeve pranë këtij Komisioni, nëse operatori ekonomik “Vëllezërit Agalliu 20” SHA ka korrigjuar apo jo pranë KPP-së dokumentin bankar që vërteton pagesën e tarifës për ankesën e paraqitur për procedurën e prokurimit të sipërcituar.

III.7. Në datën 07.05.2026, nëpërmjet shkresës nr. 843/5 prot., Sektori i Financës, Burimeve Njerëzore dhe Trajnimeve pranë KPP-së informon se: “*Në përgjigje të kërkesës suaj nr. 843/4 prot., datë 04.05.2026 me objekt: “Kërkesë për verifikim pagese”, ju bëjmë me dije se për ankesën nr. 843/2026 prot, datë 17.03.2026, me numër ankimi elektronik me nr. A/2026/6422,*

operatori ekonomik “Vëllezërit Agalliu 20” SHA nuk ka paraqitur dokumentin bankar që vërteton pagesën. Refereruar kërkesës suaj tuaj, janë kryer verifikime me raportin e Degës së Thesarit, për arkëtime të periudhës Mars- Prill dhe rezulton se operatori ekonomik “Vëllezërit Agalliu 20” SHA nuk ka kryer pagesë në favor të Komisionit të Prokurimit Publik për ankesën e sipërcituar.”

III.8. Nga verifikimet e kryera në sistemin e prokurimeve elektronike rezulton, se autoriteti kontraktor nuk ka publikuar në SPE njoftimin e fituesit/anulimit të procedurës së mësipërme të prokurimit.

III.9. Në nenin 110, pikat 2, 7 dhe 8 “Afatet për ankimim” të Ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, parashikohet shprehimisht se:

“2. Në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar, në rastin e ankesave për vendimin e vlerësimit/klasifikimit përfundimtar, operatorët ekonomikë kanë të drejtë të ankohen **brenda 10 ditëve nga publikimi i njoftimit të fituesit ose publikimi i njoftimi të anulimit.**

**Në procedurat e prokurimit nën kufirin e lartë monetar ky afat është 7 ditë.**

7. Në rast se operatori ekonomik nuk paraqet ankesën brenda afateve të parashikuara në këtë nen, atëherë nuk ka mundësi të ushtrojë më të drejtën e ankimit pranë autoritetit ose entit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

8. Të shtunat, të dielat dhe ditët e festave zyrtare nuk pengojnë fillimin dhe kohëzgjatjen e afateve. Kur dita e fundit e një afati bie e shtunë, e diel ose një ditë feste zyrtare, afati mbaron në ditën e punës që vjen pas saj. Ankesa quhet e pranuar në ditën e depozitimit të saj pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.”.

III.10. Në nenin 111, pika 1, të Ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, parashikohet shprehimisht se:

“1. Operatori ekonomik ankimes dërgon njëkohësisht ankesën në autoritetin ose entin kontraktor dhe Komisionin e Prokurimit Publik. Rregulla të posaçme për mënyrën e paraqitjes së ankesës përcaktohen në rregullat e prokurimit publik.”.

Neni 112, pikat 1 dhe 2 të Ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, parashikon shprehimisht se:

“1. Me marrjen e ankesës, autoriteti ose enti kontraktor konfirmon në databazën e të dhënave të publikuara nga Komisioni i Prokurimit Publik që ankesa është paraqitur pranë këtij institucioni. Nëse autoriteti ose enti kontraktor konstaton se ankesa nuk është paraqitur në Komisionin e Prokurimit Publik, e refuzon atë si të pavlefshme.

2. Pasi konfirmon se ankesa është paraqitur në Komisionin e Prokurimit Publik, autoriteti ose enti kontraktor pezullon vazhdimin e procedurës së prokurimit deri në shqyrtimin plotësisht të ankesës, përfshirë edhe nxjerrjen e një vendimi nga Komisioni i Prokurimit Publik.”.

III.11. Referuar bazës ligjore të sipërcituar, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se afati për dorëzimin e ankesës pranë Komisionit të Prokurimit Publik dhe autoritetit kontraktor, në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar, në rastin e ankesave për procesin e vlerësimit të ofertave, është brenda 10 ditëve nga publikimi i njoftimit të fituesit ose publikimi i njoftimi të anulimit.

Në rastin konkret, referuar verifikimeve të kryera në Sistemin e Prokurimit Elektronik, rezulton, se nga ana e autoritetit kontraktor nuk është publikuar në SPE njoftimi i fituesit/anukimit për procedurën e prokurimit objekt-ankimi, ndërkohë që operatori ekonomik ankimues ka dorëzuar ankesë nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike pranë Komisionit të Prokurimit Publik, në datën 13.03.2026.

III.12. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se referuar nenit 111, pika 1 të ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, operatori ekonomik ankimues dërgon njëkohësisht ankesën në autoritetin ose entin kontraktor dhe Komisionin e Prokurimit Publik. Në rastin konkret, referuar dokumentacionit të administruar rezulton, se operatori ekonomik ankimues ka dorëzuar ankesë pranë Komisionit të Prokurimit Publik, përpara afatit të parashikuar nga neni 110, pika 2 e Ligjit 162/2020 “Për prokurimin publik”, i cili parashikon se:

**“2. Në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar, në rastin e ankesave për vendimin e vlerësimit/klasifikimit përfundimtar, operatorët ekonomikë kanë të drejtë të *ankohen brenda 10 ditëve nga publikimi i njoftimit të fituesit ose publikimi i njoftimit të anulimit. Në procedurat e prokurimit nën kufirin e lartë monetar ky afat është 7 ditë.*”**

Referuar parashikimeve të sipërcituara, llogaritja e afatit për ankim pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar nis ditën e publikimit të njoftimit të fituesit (anulimit) dhe përfundon në ditën e 10-të. Në këtë kuptim KPP gjykon, se ankesa e administruar me numër ankimi elektronik A/2026/6422, datë 13.03.2026 dhe nr. 843/2026 protokollit, datë 17.03.2026 e operatorit ekonomik “Vëllezërit Agalliu 20” SHA për procedurën e mësipërme të prokurimit konsiderohet e paraqitur përpara afatit ligjor të ankimit, duke mos u legjitimuar *ratione temporis*.

Në nenin 118, pika 2, gërma “a” të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar parashikohet se:

*“Përpara lidhjes së kontratës, Komisioni i Prokurimit Publik ka të drejtë: të refuzojë ankesën, për shkak të mosplotësimit të elementeve të domosdoshme për shqyrtimin e saj, sipas parashikimeve të nenit 111 të këtij ligji”.*

Sa më sipër arsyetuar, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se ankesa e dorëzuar nga operatori ekonomik ankimues, nuk ka përmbushur detyrimin për ndjekjen e afateve ligjore të ankimit, ndaj përbën shkak për mospranimin e tij nga ana e Komisionit të Prokurimit Publik. Komisioni i Prokurimit Publik rithekson bindjen e tij, se për shkak të specifikës së prokurimeve publike, respektimi i afateve është i një rëndësie thelbësore, e me ndikim të drejtpërdrejtë në efikasitetin e procedurës, ndaj edhe i qëndron strikt rregullit të parashikuar nga ligji i prokurimit publik si *lex specialis* mbi lëndën.

III.13. Për më tepër, nga shqyrtimi i ankesës së operatorit ekonomik “Vëllezërit Agalliu 20” SHA dhe dokumentacionit bashkëlidhur saj, Komisioni i Prokurimit Publik konstaton, se operatori ekonomik ankimues nuk ka bashkëlidhur dokumentin bankar që të vërtetojë, se ka kryer pagesën e tarifës financiare për paraqitjen e ankesës pranë Komisionit të Prokurimit

Publik, në përputhje me përcaktimet në pikat 2 dhe 4 të nenit 111 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”.

III.14. Në nenin 111 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, është parashikuar se:  
“Operatori ekonomik ankimes dërgon njëkohësisht ankesën në autoritetin ose entin kontraktor dhe Komisionin e Prokurimit Publik në Sistemin e Ankesave Elektronike. Rregulla të posaçme për mënyrën e paraqitjes së ankesës përcaktohen në rregullat e prokurimit publik.  
2. Ankesa bëhet sipas formularit përkatës, ku shënohen emri dhe adresa e ankuesit, referimi për procedurën konkrete dhe bazën ligjore, ku ankuesi pretendon për shkeljet, pagesa e tarifës së ankesës, duke e shoqëruar atë me dokumentacionin dhe provat përkatëse, për të cilat mendon se mbështesin ankimin e tij. Elementet e sipërpërmendura janë të domosdoshme për shqyrtimin e ankesës. Ankimesi është i detyruar t’i bashkëlidhë ankimit dokumentin bankar që vërteton pagesën e tarifës përkatëse për ankesën.  
3. Nëse mungon ndonjë nga elementet e sipërpërmendura ose formulari nuk është plotësuar në mënyrën e duhur, atëherë autoriteti ose enti kontraktor duhet të vërë në dijeni ankimesin për të plotësuar formularin. Njoftimi mund të bëhet me çdo mjet të mundshëm, përfshirë edhe postën elektronike, dhe në çdo rast dokumentohet. Nëse ankesa nuk korrigjohet brenda 2 ditëve nga njoftimi, ajo vlerësohet si e paparaqitur.  
4. Në çdo rast, paraqitja e ankesës shoqërohet me mandatpagesën e bërë pranë Komisionit të Prokurimit Publik.”

III.15. Referuar pikës 2 të nenit 111 të LPP-së, si më sipër cituar, Komisioni thekson, se ligjvënësi ka përcaktuar disa elemente të domosdoshme formale për paraqitjen e ankesës njëkohësisht pranë Komisionit të Prokurimit Publik dhe autoritetit kontraktor. Një prej elementeve të domosdoshme për paraqitjen e ankesës është edhe dokumenti bankar, që vërteton pagesën e tarifës përkatëse për ankesën. Ndërsa referuar pikës 3 të nenit 111 të LPP-së, Komisioni gjykon, se ligjvënësi i ka dhënë një mundësi ankimesve, që të korrigjojnë ankesat e tyre në rast se konstatohet mungesa e një apo më shumë elementeve formale të përcaktuara në pikën 2 të nenit 111 të LPP-së. Me anë të kësaj mundësie, ligjvënësi ka dashur të përcjellë frymën, se nuk mund t’i refuzohet e drejta e ankimit subjekteve që pretendojnë se dëmtohen ose rrezikojnë të dëmtohen nga një vendimmarrje e autoritetit kontraktor në mënyrë apriori, vetëm për shkak të disa mungesave formale, të cilat mund të korrigjohen lehtësisht brenda një afati të arsyeshëm, që nuk cenon parimin e efijencës në procedurat e prokurimit publik. Bazuar në dispozitën e mësipërme, për të konstatuar mungesat lidhur me elementet formale të ankesës, si dhe për të vënë në dijeni ankimesin lidhur me mungesat e konstatuara, është detyrim i autoritetit kontraktor, i cili duhet të njoftojë menjëherë ankimesin me çdo mjet të mundshëm, duke i lënë 2 ditë kohë për të korrigjuar elementet e domosdoshme formale të ankesës.

Komisioni i Prokurimit Publik thekson faktin, se përcaktimi i procedurave të caktuara në LPP dhe Rregullat e Prokurimit Publik, duke filluar nga përgatitja e ofertës, shqyrtimi i ofertave, ankimi, si dhe mundësia për të korrigjuar mangësitë lidhur me elementet e domosdoshme formale të ankesës, përfaqësojnë garanci dhe siguri juridike për palët e interesuara. Parimi i ligjshmërisë është ndër parimet kryesore të veprimtarisë së organeve të administratës publike. Gjithashtu, ndër parimet kryesore të zhvillimit të procedurave të prokurimit, parashikuar nga lex specialis LPP, janë ato të mosdiskriminimit, transparencës dhe barazisë. Tërësia e

elementeve të mësipërme, lidhet ngushtësisht me elemente të ligjshmërisë së vendimeve të organeve të administratës publike.

Në kushtet kur ankimuesi nuk ka paguar tarifën financiare të ankesës, edhe pas vënies në dijeni të tij nga Komisioni i Prokurimit Publik, si më sipër cituar, ky Komision gjykon, se ankesa e operatorit ekonomik “Vëllezërit Agalliu 20” SHPK, nuk plotëson një prej elementeve të domosdoshme për shqyrtimin e ankesës, ndaj, bazuar në germën “a” të pikës 2, të nenit 118 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, kjo ankesë duhet refuzuar.

Për sa më sipër, në mbështetje të nenit 30 dhe 118 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 236, datë 20.04.2023 “Për përcaktimin e tarifës dhe të rregullave për pagimin e saj, në një procedurë ankimi, pranë Komisionit të Prokurimit Publik”, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, nenit 4, të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik njëzëri,

### **Vendosi**

1. Të mos pranojë ankesën e operatorit ekonomik “Vëllezërit Agalliu 20” SHA për procedurën e prokurimit “E hapur mbi kufirin e lartë monetar”, me nr.REF-70374-11-26-2025, me objekt: “Lot 3: Blerje vajra, lubrifikantë dhe alkool frenash”, me fond limit 18,678,720 lekë pa tvsh, zhvilluar me datë 08.01.2026 nga autoriteti kontraktor, Drejtoria e Pergjithshme e Pastrimit dhe Gjelberimit.
2. Autoriteti kontraktor lejohet të vijojë me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit të sipërcituar.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.
4. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

### **KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK**

**Anëtar**  
**Anila Malaj**

**Anëtar**  
**Kreshnik Ternova**

**Anëtar**  
**Gjergj Mersini**

**Nënkryetar**  
**Fiovent Zguro**

